



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:234730
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05452959

C – IV. – 15– 1058

Paditësja :

Kompania, , ‘M’AD me seli në N N Republika e Malit të Zi, e të cilën me autorizim, e përfaqëson, av. O C nga Peja.

Kundër

E paditura :

NSh, ‘Kombinati i Lëkurës dhe Këpucëve ’ me seli në Pejë e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. ‘Dritan Hoxha’, nr.55, Prishtinë.

Objekti i çështjes : Kompensimi monetar.

Për: Palët.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjykatësin, Agron Hoxhaj, me **dt.14.3.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses, Kompania, , ‘M’AD me seli në Nikshiq e ushtruar kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë lidhur me Vendimin, PEJ173 – 1063 të dt.21.05.2015 të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë (AKP) e me të cilin është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditëses për kompensimin e kërkesës shumë prej 218,247.74 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), ‘Kombinati i Lëkurës dhe Këpucëve’ me seli në Pejë (në likuidim) dhe i njëjti Vendim, **VËRTETOHET si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Procedurale dhe Faktike :

Paditësi me dt.08.06.2015 pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), ka paraqitur kërkesë për vërtetimin e ekzistimit të kërkesës kreditore kundër Vendimit, PEJ173 –1063 i dt.21.05.2013 të Autoritetit të Likuidimit (AL) në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë e me të cilin, të njëjtës, i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për

kompensimin e kërkesë kreditore në shumën prej 218.247,74 USD nga Ndërmarrja Shoqërore, NSh, "Kombinati i Lëkurës dhe i Këpucëve" me seli në Pejë (në Likuidim) dhe se përmes kësaj kërkesë, ka kërkuar nga gjykata që pas shikimit në të gjitha shkresat e lëndës, të nxjerr Vendim e me të cilin do të vërtetohet ekzistimi i kërkesës kreditore e kreditorës, Kompania, , 'M'AD me seli në N ndaj Ndërmarrjes Shoqërore (NSh), "Kombinati i Lëkurës dhe i Këpucëve" me seli në Pejë e me të cilën administron Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë në shumën prej 218.247,74 USD e në kundërvlerë të në euro në ditën e pagesës sipas vlerës së favorshme e me kamatë nda dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesa definitive.

Në arsyetimin e vendimit të tij, AL-ja është bazuar në atë se kërkesa pranë AL-së, ishte bërë në afatin e paraparë ligjor me dt.05.11.2013 mirëpo pas shqyrtimit paraprak të kërkesës së paditëses, ka gjetur se informatat e siguruara nga paditësi ishin jo të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi sipas kërkesës së paditëses dhe se për këtë arsye. AL-ja, me dt.01.010.2014, nga paditësja, ka kërkuar informata shtesë, siç janë : kontrata në mes NSh, "Kombinati i Lëkurës dhe i Këpucëve" me seli në Pejë dhe Kompanisë, , 'M'AD me seli në N e nga e cila rrjedh kërkesa kreditore, kopja e faturës me nënshkrim të personit i cili e ka marr mallin dhe dërguar (dispeçeri) e vërtetuar me vulën e ndërmarrjes, urdhëresa e ekzekutimit e dhënë nga Gjykata Komunale në Pejë e lidhur me aktgjykimin C.nr.661/94 të dt.15.05.1998, si dhe cilin do dokument i cilin mund të jetë me dobi për administratorin falimentues dhe për vendimmarrje të drejtë sipas kërkesës.

AL-ja në mes tjerash, në arsyetimin e këtij Vendimi, ka theksuar se paditësja, duke vepruar sipas kësaj parashtrës, ka sjell disa dokumente shtesë por se paditësja, nuk e ka dorëzua Urdhëresën e ekzekutimit e dhënë nga Gjykata Komunale në Pejë lidhur me aktgjykimin, C.nr.661/94 të dt.15.05.1998 i cili ishte kërkuar nga AL-ja, në procedurën e likuidimit dhe se për këtë arsye është bazuar në nenin 36.22 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 033 të AKP-së i cili parasheh se : " ... dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese..." dhe se ka vendosur që të refuzoj si të pavlefshme të kërkesës së paditëses më gjerësisht ka vendosur si këtë Vendim të kontestuar.

Pala paditëse parashtrësën e ka titulluar si "kërkesë për vërtetimin e ekzistimit të kërkesës kreditore" mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtrësave me të cilat bëhet "nisja e procedurave" pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Paditësja në këtë padi në mes tjerash ka theksuar se paditësi, si palë kreditore, tek AKP-ja, ka bërë kërkesë AKP-së - NSh, "Kombinati i Lëkurës dhe i Këpucëve" me seli në Pejë përkatësisht organit kompetent për likuidim, me të cilën e ka paralajmëruar kërkesë e saj ndaj kësaj NSh-je, në shumën prej 218.247,74 USD e në kundërvlerë të në euro në ditën e pagesës sipas vlerës së favorshme e me kamatë nda dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesa definitive dhe se kësaj kërkesë, i ka bashkangjitur provat relevante të cilat e provojnë ekzistimin e kërkesës kreditore, se NSh-ja përmes zyrtarit përgjegjës të likuidimit, ka marr vendim e me të cilin, të njëjtës, i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensimin e kërkesë kreditore në shumën prej 218.247,74 USD nga Ndërmarrja Shoqërore, NSh, "Kombinati i Lëkurës dhe i Këpucëve" me seli në Pejë, dhe se ky qëndrim i administratorit të likuidimit, është i pabazuar dhe jo ligjor, se kreditorja e në rastin konkret Kompania, , 'M'AD me seli në N brenda afati ligjor e ka paralajmëruar kërkesë e saj me dt.05.11.2013 dhe se afati i fundit për paraqitjen e saj ka qenë dt.08.11.2013 dhe ka deponuar dokumentet e besueshme me të cilat provohet ekzistimi i kërkesës së saj , se paraprakisht i ishte drejtuar organit kompetent për pranimin e kërkesave, AKP-së me dt.17.03.2005 me kërkesë nr.120 e evidentuar tek , 'M'AD me seli në N.

Tutje ka shtuar se Organi i likuidimit duke e konsideruar kërkesën jo të plotë, me parashtrësën e dt.29.9.2014, ka kërkuar dokumentet plotësuese e në mesin e të cilave janë : kontrata në mes NSh, 'Kombinati i Lëkurës dhe i Këpucëve' me seli në Pejë dhe Kompania, , 'M'AD me seli në N e nga e cila rrjedh kërkesa kreditore, kopja e faturës me nënshkrim të personit i cili e ka marr mallin dhe dërguar (dispeçeri) e vërtetuar me vulën e ndërmarrjes, urdhëresa e ekzekutimit e dhënë nga Gjykata Komunale në Pejë e lidhur me aktgjykimin C.nr.661/94 të dt.15.05.1998, si dhe cilin do dokument i cilin mund të jetë me dobi për administratorin falimentues dhe për vendimmarrje të drejtë sipas kërkesës, se paditësja duke vepruar sipas kësaj parashtrëse, të gjithë dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, C.nr.661 – 94 të Gjykatës Ekonomike me seli në Podgoricë, e tash Gjykatës Ekonomike dhe atë të gjithë ato dokumente të cilat janë specifikuar në arsyetimin e aktgjykimit të lartë cekur në faqen e 2-të pasuesi i IV-t nga rreshti i dytë deri në fund të pasuesit përfshirë edhe kontratën Nr.1130, të gjitha faturat dhe dërgesat me nënshkrim dhe vulë të pjesëmarrësës në raportin juridiko ekonomik, se paditësja, nuk e ka dorëzuar vetëm Urdhëresën e ekzekutimit e dhënë nga Gjykata Komunale në Pejë lidhur me aktgjykimin, C.nr.661/94 të dt.15.05.1998, se nga këto arsye e veçanërisht vetëm në mungesë të vetëm kësaj urdhërese administratori falimentues, nxjerr vendimin e ankimuar e me të cilin e ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar, e duke u bazuar në nenin 36 par.6 pikën 2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 033 të AKP-së, se thirrja vetëm në këtë dispozitë të këtij neni, dhe nën paragrafit të këtij ligji, e bëjnë vendimin e pa qartë sepse paragrafi 6 i këtij neni nuk ekziston dhe i është i njohur vetëm këtij organi, se nën supozimin se bëhet fjalë për thirrjen në nenin 36 par.2, pika 2.2 të këtij Ligjit (e që nuk e liron vendimin e kontestuar nga paligjshmëria e tij në këtë kuptim), atëherë konsideron se organi i likuidimit e ka shkelur ligjin në fjalë në mënyrën e zbatimit të drejtë të tij, e duke e cituar edhe nenin 36 të këtij Ligji se : *'Autoriteti i Likuidimit refuzon, tërësisht apo pjesërisht, vlefshmërinë e Kërkesave apo interesit të pretenduar të kapitalit apo pronësisë nëse refuzimi i tillë obligohet apo lejohet sipas këtij ligji apo elementeve tjera të ligjeve të Kosovës në fuqi apo me urdhër të gjykatës pa kufizuar fushëveprimin apo zbatueshmërisë e paragrafit 1 më sipër, elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: 2.1.kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme; 2.2.dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese...'*

Po ashtu ka shtuar edhe se administratori falimentues, gabimisht e ka zbatuar dispozitën e cituar ligjore dhe paditësja, ka sjell dokumentacioni përkatës përveç që mungon Urdhri i gjykatës për ekzekutim, se nga kjo rrjedh se kreditorka, ka siguruar dokumentet e vlefshme e duke i cekur disa nga faktet (rrethanat), se kërkesa është e vërtetuar pranë gjykatës kompetent në Podgoricë, dokumenti i besueshëm dhe e pajisur vulën e ekzekutueshmërisë etj e me propozimin që gjykata të nxjerr aktgjykim e me të cilin do të vërtetohet ekzistimi i kërkesës kreditore e kreditores, Kompania, , 'M'AD me seli në Nikshiq ndaj Ndërmarrjes Shoqërore, NSh, 'Kombinati i Lëkurës dhe i Këpucëve' me seli në Pejë e me të cilën administron Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë në shumën prej 218.247,74 USD e në kundërvlerë të në euro në ditën e pagesës sipas vlerës së favorshme e me kamatë nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesa definitive e më gjerësisht si në këtë kërkesë.

Paditësi kësaj padie, ia ka bashkangjitur provat : kopjen e Vendimit, PEJ173 –1063 i dt.21.05.2013 të Autoritetit të Likuidimit (AL) të AKP-së, kopjen e noterizuar të aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike me seli në Podgoricë të Republikës së Malit të Zi, C.nr.661/94 të dt.15.05.1998 për pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së paditësës për një pjesë të saj dhe për shpenzimet procedurale si dhe refuzimin e pjesshëm për pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësës, kopjen e shkresës së dt.30.06.2015 të av O C nga Peja, i autorizuari paditësës të drejtuar AKP-së me seli në Prishtinë, si paralajmërim për paraqitjen e padisë, kopjen e aneksit

të Kontratës, Nr... të dt.. të lidhur në mes të NSh, ”Kombinati i Lëkurës dhe i Këpucëve” me seli në Pejë dhe DD, , ‘M’, N kopjen e Formularit të AKP-së të plotësuar të dt.20.05.2013, dhe kopjen e autorizimit për përfaqësim të dhënë nga paditësja për av. O C nga Peja gjerësisht si në këtë kërkesë.

Me dt.16.05.2016, i autorizuari i paditëses – kreditores, i është drejtuar sërish DhPGjSK-së lidhur me procedimin e çështjes.

Me dt.08.07.2016, i autorizuari i paditëses – kreditores, i është drejtuar DhPGjSK-së lidhur me çështjen në fjalë e duke e bërë precizimin e kërkesëpadinë e saj e me të cilën nga gjykata ka kërkuar që të nxjerrë këtë aktgjykim e me të cilin, aprovohet padia, detyrohet e paditura, NSh, ”Kombinati i Lëkurës dhe i Këpucëve” me seli në Pejë dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit e cila administron me këtë ndërmarrjes që paditëses, DD, , ‘M’, me seli mn N Republika e Malit të Zi, t’ia kompensoj shumën 297.490,14 USD e në kundërvlerë të në euro në ditën e pagesës sipas vlerës së favorshme e me kamatë nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesa definitive e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Me dt.27.07.2017 e paditura, AKP-ja, ka paraqitur mbrojtjen në ankesën e paditëses të ushtruar kundër Vendimit, PEJ173 –1063 i dt.21.05.2013 të Autoritetit të Likuidimit (AL) në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë e në të cilën ka theksuar, se AL-ja, ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore të zbatueshme gjithashtu janë zbatuar saktësisht, se paditësja, nuk ka prezentuar asnjë argument juridik e me këtë nuk ka respektuar nenin 70.2 dhe 27.2.4 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 033 për AKP-në, i cili e obligon paditësin që në ankesën e tij të paraqes argumentet juridike, se duke marrë për bazë faktin i pa kontestuar se kërkesa pranë Gjykatës Ekonomike në Podgoricë, të dt.23.10.2000, parashtruesja e kërkesës - paditësja, nuk vërehet se që ka ndërmarrë çfarëdo veprimi për realizimin e kërkesës në vitin 2000, se kërkesa e paditëses, është bërë në kundërshtim me nenin 36 par.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 033 për AKP-në, i cili parasheh se :”*Pa kufizuar fushëveprimin apo zbatueshmërisë e paragrafit 1 më sipër, elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: 2.1.kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme si dhe në nenin 379 të Ligjit për Obligatat, i cili parasheh se :” Të gjitha kërkesat që janë përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me anë të pajtimit para gjykatës ose organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë vjet ...“.* Tutje ka shtuar se kërkesa e cila është bërë në afat për dorëzimin e kërkesave, nuk e ndërron parashkrueshmërinë e kërkesës sepse ekzistoj 2 (dy) afate, dhe i pari është afati për dorëzimin e kërkesave në procedurën e likuidimit (neni 7.2.6.2 i Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 033 për AKP-në kurse afati i dytë ka të bëjë me natyrës (meritën) e ligjit, nga të cilat implementimi i kërkesave të parashtruesve të kërkesave e që pas kësaj parashtruesja e kërkesës, ka bërë kërkesë në bazë të vendimit gjyqësor, afatit të paraparë që është 10 vjeçar , në pajtim me nenin 36.2 pika1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 033 për AKP-në, pra paditësi, nuk e ka ndërprerë periudhën e kufizimit dhe për shkak të saj kërkesa e tij është refuzuar, se këto dy afate janë të ndara dhe të ndryshme, se paditësi, te dy këto dy afate duhet t’ respektoj që kërkesa e tij të ishte e pranuar si dhe se i ka propozuar gjykatës që të refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit dhe të vërtetohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit në zbatim të nenit 70.4 të Shtojcës së Ligjit, Nr. 04/L-033 .

Me dt.18.08.2017, av. O C nga Peja, i autorizuari i paditëses, i është drejtuar DhPGjSK-së e me të cilën i ka kontestuar thëniet e të paditurës të dhëna në Mbrojtjen në padi, se ajo si palë paditëse, me kohë pranë AL-së e ka bërë kërkesën e saj e më gjerësisht si në këtë parashtrësë të bërë në mbrojtjen e të paditurës.

Me dt.30.08.2017, e paditura, AKP-së me seli në Prishtinë, në përgjigjen e paditëses, ka paraqitur Kundërpërgjigje e në të cilën, ka vënë në pah dispozitat e nenit 7 të LPK-së dhe nenit 23 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 033, sa i përket asaj se kush e ka barrën e të të provuarit, se paditësi, nuk ka ofruar asnjë dëshmi në lidhje me kompensimin si dhesë nuk ka arritur që t'i kontestoj disa nga argumentet juridike të cekura në Vendimin e organit të Likuidimit e më gjerësisht si në këtë Kundërpërgjigje.

Arsyetimi ligjor:

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa – kërkesa, nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata ka marr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata vlerësoj se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses, AD, , ‘M’’, me seli në N Republika e Malit të Zi, është e pa bazuar.

Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditëses.

Gjykata konstaton se Ndërmarrja Shoqërore (NSh), ‘Kombinati i Lëkurës dhe Këpucëve’ me seli në Pejë, në procedurën e likuidimit, ka hyrë me dt.16.06.2013 derisa kërkesën kreditore tek Autoriteti i Likuidimit (AL) në procedurën e likuidimit, e ka bërë me dt.05.11.2013, pra brenda afatit paraparë i cili ka qenë me dt.08.11.2013 dhe se pas pranimi të këtij Vendimi të AL-së nga pala kreditore pas dt.26.05.2013, kërkesë për vërtetimin e ekzistimit të kërkesës kreditore - padinë paditësi kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), PEJ173 –1063 i dt.21.05.2013, pranë Dhomës së Posaçme, e ka bërë përmes dërgimit me postë me dt.08.06.2013, pra brenda afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve pas ditës së pranimi për ushtrimin e saj pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) dhe se kësaj kërkesë, i ka bashkangjitur edhe Vendimin e kundërshtuar të Autoritetit të Likuidimit (AL), PEJ173 –1063 i dt.21.05.2013.

Andaj, është vlerësim i kësaj gjykate se kërkesa e paditësit për vërtetimin e ekzistimit të kërkesës kreditore - padinë i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshmërisë nga neni 36 lidhur me nenin 33 dhe 35 dhe 74 të Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK) dhe nenit 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në.

Faktet jo kontestuese dhe kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata konstaton se mes paditëses, dhe Ndërmarrja Shoqërore (NSh), ‘Kombinati i Lëkurës dhe Këpucëve’ me seli në Pejë, ka ekzistuar raporti materialo juridik dhe se paditësja, në procedurën e likuidimit, ka bërë kërkesë me dt.05.11.2013 derisa nuk është kontestuese se kërkesën kreditore tek Autoriteti i Likuidimit (AL) në procedurën e likuidimit, e ka bërë me dt.05.11.2013, pra brenda afatit paraparë i cili ka qenë me dt.08.11.2013 dhe se pas shqyrtimit të saj, AL-ja me Vendimin e tij, PEJ173 –1063 i dt.21.05.2013, kërkesën e saj për kompensimin e kërkesë kreditore në shumën prej 218.247,74 USD nga Ndërmarrja Shoqërore, NSh, ‘Kombinati i Lëkurës dhe i Këpucëve’ me seli në Pejë (në Likuidim), ia ka refuzuar si të pa vlefshme por kontestuese na mbetet çështja se pala paditësja a e ka bërë në afat kërkesën e saj e që lidhet me zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike me seli në Podgoricë të Republikës së Malit të

Zi, C.nr.661/94 të dt.15.05.1998 për pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së paditëses për një pjesë të saj dhe për shpenzimet procedurale si dhe refuzimin e pjesshëm për pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses.

Në rastin konkret, gjykata ka konstatuar se kërkesa e paditësit, ka të bëjë me kërkesat e pa siguruara e të parapara si lloj i kërkesave, në nenin 40 par.1 pika 1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në e në të cilin, parashihet se : *''Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... kërkesat e pa siguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë''*.

Në nenin 42 par.2 dhe 3 i Ligjit për Dhomën e Posaçme, parashihet se : *''Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese). Secilës palë tjetër do ti jepet mundësia e arsyeshme për ta kontestuar legjitimitetin apo saktësinë e provave të tilla, nëpërmjet paraqitjes së parashtrësave apo provave tjera (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese) me anë të së cilave synohet përgënjeshtrimi i legjitimitetit apo saktësisë së provave të tilla. Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë. Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë''*.

Po ashtu në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës , parashihet se: *''Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore''* derisa sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *''Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla''*.

Në bazë të nenit 36 par.2 pika 1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, parashihet se *''... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme''* derisa në bazë të 379 të Ligjit për Marrëdhënien e Detyrimeve (LMD), Gazeta Zyrtare, RSFJ nr.29/78, i cili parasheh se : *'' Të gjitha kërkesat që janë përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me anë të pajtimit para gjykatës ose organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë vjet ...''*.

Gjykata vëren se kërkesa e parashtruar, është jashtë afatit të paraparë ligjor për të kërkuar kompensimin e kërkesë kreditore në shumën prej 218.247,74 USD nga Ndërmarrja Shoqërore, NSH, ''Kombinati i Lëkurës dhe i Këpuçëve'' me seli në Pejë (në Likuidim), si palë e paditur pasi që paditësja, nuk ka arritur që të bind gjykatën se ka iniciuar procedurën gjyqësore e në funksion të realizimit të aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike me seli në Podgoricë të Republikës së Malit të Zi, C.nr.661/94 të dt.15.05.1998 për pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së paditëses për një pjesë të saj dhe për shpenzimet procedurale si dhe refuzimin e pjesshëm për pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses sepse po që se shikohet nga vula e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, aty vërehet dat.31.10.2000 derisa kërkesën pranë Autoritetit të Likuidimit (AL), pala paditëse, e ka bërë tek me dt.05.11.2013, pra që ka kaluar 10 (dhjetë) vjet nga dita e të bërit të plotëfuqishëm të aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike me seli në Podgoricë të Republikës së Malit të Zi, C.nr.661/94 të dt.15.05.1998 derisa nuk ka prova se para kësaj date, paditësja, t'i ishte drejtuar ndonjë gjykate për realizimin e këtij aktgjykimi në procedurën e përmbartimit.

Vlerësimet përfundimtare të gjykatës.

Gjykata pra pasi shqyrtoi provat që gjendjen në shkresat e lëndës, dhe vlerësimin të tyre, si dhe pas që konstatoj gjendjen faktike, ka ardhur në përfundimin se e paditura, ka zbatuar drejtë dispozitat e nenit 36 par.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 033 për AKP-në, dhe dispozitat e nenit 379 të Ligjit për Marrëdhënien e Detyrimeve (LMD), kur me Vendimin e saj, PEJ173 – 1063 të dt.21.05.2013, paditëses, ia kishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensimin e kërkesë skreditore në shumën prej 218.247,74 USD nga Ndërmarrja Shoqërore, NSh, "Kombinati i Lëkurës dhe i Këpucëve" me seli në Pejë (në Likuidim), andaj duke qenë se pala paditëse, nuk ka prova se para se t'i drejtohet Autoritetit të Likuidimit (AL), në procedurën e likuidimit për kërkesën e saj, brenda afati prej 10 (dhjetë) vjetëve, t'i ishte drejtuar si palë paditëse ndonjë gjykatë apo autoritetit tjetër kompetent për realizimin e këtij aktgjykimi, dhe se për këtë arsye, edhe kërkesa e paditëses, është kërkesë e parashkruar, kjo gjykatë vendosi e më gjerësisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj me arsyet e cekura më lartë në këtë çështje juridiko – civile, kjo gjykatë, kërkesëpadinë e paditëses, Kompania, , 'M'AD me seli në N e ushtruar kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë lidhur me Vendimin, PEJ173 – 1063 të dt.21.05.2015 të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë (AKP) e me të cilin është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditëses për kompensimin e kërkesës shumën prej 218,247.74 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSH), "Kombinati i Lëkurës dhe Këpucëve" me seli në Pejë (në likuidim), duhet t'a refuzojë si të pabazuar dhe Vendimin e AL-së, PEJ173 – 0291 të dt.18.12.2013 të Autoritetit të Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore, NSh, "Kombinati i Lëkurës dhe i Këpucëve" me seli në Pejë (në Likuidim), e vërtetoj si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të japë arsyetime tjera ligjore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par.5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata vendosi që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në këtë çështje kontestimore.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2022:234730, 14.03.2024

**Gjykatësi
Agron Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).